



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: (KEK sha)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: (KEKO-17-137-111)

Sa i përket tenderit për : "Furnizim me Pompa Centrifugale horizontale për largimin e ujit"

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

"ND" shpk  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Veternik Zona e re 1  
(Adresa)

Prishtine  
(Vendi)

100000

(Kodi postar)

044 ~~111111~~  
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Dila Hasanaj  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

~~www.dila.com~~  
(Adresa elektronike)

11.09.2107  
(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:  
NA

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)



## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

1. Neni 7 i LPPRK- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
2. Neni 59 i LPPRK " Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve"
3. Neni 60 i LPPRK; Kriteret për Dhënien e Kontratës.
4. Neni 41 te UOPP
5. Neni 4.1 Seksioni II i FTD i DT te AK.
6. Pjesa C e DT pika 1 dhe 5

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**1. Pika 1 ankimore.** Bazat e opinionit të panelit të KEK-ut për shpalljen e OE N.T.P. "SNR" fitues janë të paqëndrueshme dhe në kundërshtim me vetë kërkesat e specifikimeve teknike të AK.

Në vijim po i përshkruajmë kërkesat e AK sipas DT dhe sqarimeve shtese:

**Aneksi I Specifikimet teknike të detyrueshem te DT**

### Karakteristikat Teknike të Pompes :

#### Vërejtje :

a) Me karakteristika teknike të njëjta të pompave centrifugale përparsi ka pompa e cila e ka lymjen e kushinetave me vaj. Përcaktohem i që lymeja e kushinetave të bëhet me Vaje.

c) pompa centrifugale duhet të jetë rezistente ndaj ujrave sipërfaqësore me sasi të Lymit dhe ujrave nëntokësore me sasi të përbërjes kimike Sulfurit, të dokumentohet në përshkrimin teknike të formes konstruktive të pompes dhe përbërjes së materialit në fazën e ofertimit. Uji i cili kalon nëpër pompe është uje i turbullt i cili vjen nga rrjedhjet e ujit nëpër kanale deri te rezervari i pompes ,mbetjet e ngurta janë të përmasave përafërsisht 2-3 mikron.

- 1.1-OE fitues te katalogu nr.1 të evidentuar sipas nesh nuk e saktëson tipin e pompes(Performance range Point)
- 1.2-Pastaj te rreshti i katalogut Konstruktion pika 3 OE fitues e ka rrumbullaksuar (600-6)kjo është pompa DM e jo D që oferton fituesi,kushinetat lyhen me vaj ndërsa te katalogu nr.2 prerja e tërthort e të gjitha tipeve të pompave poz.14 kushinetat janë me lyrje yndyre (është në kundërshtim me kërkesen e AK pika a).
- 1.3-Në katalogun nr.2 prerja e tërthort e pompes figuron pompa 4 shkallëshe ndërsa në katalogun nr.3 OE fitues oferton pompen 3 shkallëshe ku nuk e respekton piken C të karakteristikave teknike të pompes së kërkuar nga AK.
- 1.4-Në katalogun numër 3 OE fitues oferton pompen 3 shkallëshe për 600 m3/h e cila e ka vlerën për kofecientin e shfrytëzimit 82% ndërsa në diagramin e po të njëjtit katalog figuron vlera e kofecientit të shfrytëzimit 90% nuk duhet të ketë kësi ndryshime të paharmonizuara.Jan varianta të pautorizuara.

